

**Lengarica & Energy sh. p. k.**

**Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

## **Përmbajtja**

	<b>Page</b>
Bilanci kontabël më 31 dhjetor 2012	2
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012	4
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012	5
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	6 – 15

## Raport i audituesit të pavarur

Për aksionarët e Lengarica & Energy sh.p.k.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Lengarica & Energy sh.p.k. ("shoqëria") të cilat përbëhen nga bilanci më 31 dhjetor 2012, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e fluksit të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur më këtë datë si dhe nga një përmbledhje e parimeve të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacion tjetër shpjegues.

### Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri, dhe për çdo kontroll të brendshëm që drejtimi përcakton si të rëndësishëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit.

### Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të përfituar siguri të arsyeshme për mungesën e gabimeve materiale në pasqyrat financiare.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për mbledhjen e evidencave të auditimit që mbështesin shumat dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato për shkak mashtrimesh apo gabimesh. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për të përcaktuar procedurat e auditimit që i përshtaten rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të njësisë ekonomike. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur opinionin tonë.


### Opinionit


Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozicionit financiar të shoqërisë më 31 dhjetor 2012 si dhe të performancës së saj financiare dhe të flukseve të parasë për vitin e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri.

### Çështje tjetër

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011 nuk janë audituar. Opinioni ynë nuk është kualifikuar në lidhje me këtë çështje.

  
PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.





Kledi Kodra  
Ekspert Kontabël i Regjistruar

7 maj 2013  
Tiranë, Shqipëri

# Lengarica & Energy sh. p. k.


## Bilanci kontabël Më 31 dhjetor 2012


(shumat në Lekë)

Bilanci	Shënime	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011 paaudituar
<b>Aktivet</b>			
<b>I. Aktivet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	4	1,681,770	407,592
Aktive afatgjata jomateriale	5	122,511,265	77,157,186
Llogari të arkëtueshme nga koncesioni	6	91,883,448	57,867,890
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>216,076,483</b>	<b>135,432,668</b>
<b>II. Aktivet afatshkurtra</b>			
Aktive të tjera afatshkurtra	7	30,354,395	16,316,640
Parapagimet për tatimin mbi fitimin		215,000	210,000
Mjete monetare	8	49,172,894	26,337,182
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>79,742,289</b>	<b>42,863,822</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>295,818,772</b>	<b>178,296,490</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali</b>			
<b>I. Kapitali</b>			
Kapitali aksionar		344,100,000	100,000
Humbjet e mbartura		(30,980,867)	(4,864,727)
Humbja e vitit		(62,663,121)	(26,116,140)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>250,456,012</b>	<b>(30,880,867)</b>
<b>II. Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme	10	13,685,682	40,125,501
Huamarrje	11	-	151,392,585
Detyrime të tjera afatshkurtra	12	31,677,078	17,659,271
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>45,362,760</b>	<b>209,177,357</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>45,362,760</b>	<b>209,177,357</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>295,818,772</b>	<b>178,296,490</b>

Bilanci duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Lengarica & Energy sh. p. k dhe firmosur nga:

  
Fatbardh Çingu  
Administrator i përgjithshëm

  
REZARTA KOCOLLARI  
EKSPERTE KONTABEL  
NR. LIKENSE 259  
Fatarta Kocollari  
Kontabiliste



# Lengarica & Energy sh. p. k.

## Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(shumat në Lekë)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011 paaudituar
<b>I. Shitjet</b>		-	-
<b>II. Të ardhura të tjera</b>		851,673	-
		<u>851,673</u>	-
<b>III. Shpenzimet</b>			
Shpenzime për personelin	13	(867,233)	(2,008,891)
Shpenzime të veprimtarisë	14	(45,999,191)	(20,103,220)
Shpenzimet të amortizimit	4	(279,488)	(94,275)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<u>(47,145,912)</u>	<u>(22,206,386)</u>
<b>Humbja nga veprimtaria kryesore</b>		(46,294,239)	(22,206,386)
<b>Të ardhura dhe shpenzime financiare</b>	15		
Shpenzime interesi		(14,917,180)	(5,446,883)
(Shpenzime)/të ardhura nga kurset e këmbimit		(1,451,702)	1,537,129
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>		<u>(16,368,882)</u>	<u>(3,909,754)</u>
<b>Humbja para tatimit</b>		(62,663,121)	(26,116,140)
Tatimi mbi fitimin	16	-	-
<b>Humbja e vitit</b>		<u>(62,663,121)</u>	<u>(26,116,140)</u>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## Lengarica & Energy sh. p. k.

### Pasqyra e ndryshimeve në kapital Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(shumat në Lekë)

	Kapitali aksionar	Humbja e akumuluar	Totali
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2010</b>			
<b>Paaudituar</b>	<b>100,000</b>	<b>(4,864,727)</b>	<b>(4,764,727)</b>
Kapital i paguar	-	-	-
Humbja e vitit	-	(26,116,140)	(26,116,140)
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2011</b>			
<b>Paaudituar</b>	<b>100,000</b>	<b>(30,980,867)</b>	<b>(30,880,867)</b>
Kapital i paguar	344,000,000	-	344,000,000
Humbja e vitit	-	(62,663,121)	(62,663,121)
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2012</b>	<b>344,100,000</b>	<b>(93,643,988)</b>	<b>250,456,012</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Lengarica & Energy sh. p. k.

## Pasqyra e flukseve monetare Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(shumat në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011 paaudituar
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
Humbja pas tatimit		(62,663,121)	(26,116,140)
<i>Rregullime për:</i>			
Shpenzime të amortizimit	4	279,488	94,274
Shpenzime interesash	15	14,917,180	5,446,883
<b>Fitimi operativ përpara ndryshimit në kapitalin e punës</b>		<b>(47,466,453)</b>	<b>(20,574,983)</b>
Rritje në tepricën e llogarive të arkëtueshme		(14,037,756)	(11,668,324)
Rritje/(zvogëlim) në tepricën e llogarive të pagueshme		(26,439,819)	31,214,302
Rritje në tepricën e detyrimeve të tjera afatshkurtra		14,017,807	17,659,271
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>(73,926,221)</b>	<b>16,630,266</b>
Tatim-fitimi i paguar		(5,000)	(210,000)
Interesa të marra		-	10,430
<b>Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>(73,931,221)</b>	<b>16,430,696</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit</b>			
Aktive afatgjata jomateriale	5	(45,354,079)	(65,472,602)
Llogarite të arkëtueshme nga koncesioni	6	(34,015,558)	(49,104,451)
Aktive afatgjata materiale	4	(1,553,665)	(63,670)
<b>Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e investimit</b>		<b>(80,923,302)</b>	<b>(114,640,723)</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e financimit</b>			
Huamarrje nga palët e lidhura	11	(148,516,170)	122,288,640
Rritje e kapitalit aksionar	9	344,000,000	-
Interes i paguar		(17,793,595)	(2,822,823)
<b>Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e financimit</b>		<b>177,690,235</b>	<b>119,465,817</b>
<b>Rritje neto e mjeteve monetare</b>		<b>22,835,712</b>	<b>21,255,790</b>
<b>Mjetet monetare në fillim të periudhës</b>		<b>26,337,182</b>	<b>5,081,392</b>
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>		<b>49,172,894</b>	<b>26,337,182</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6– 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Lengarica & Energy sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

---

### 1. Informacion i përgjithshëm

Lengarica & Energy sh. p. k. është një filial i zotëruar në masën 99.9% nga shoqëria Enso Hydro Energji sh. p. k. (me seli në Tiranë, Shqipëri), e cila është 100% filial i shoqërisë Enso Hydro GmbH, shoqëria mëmë me seli në Austri. shoqëria është themeluar më 25 Qershor 2008 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numrin unik të identifikimit K83026602A dhe seli në Tiranë, Shqipëri.

Veprimtaria kryesore e shoqërisë është ndërtimi, përdorimi, blerja dhe shitja e hidrocentraleve, prodhimi i energjisë elektrike dhe shitja e saj për klientët dhe distributorët me shumicë.

Administratorët e Përgjithshëm të shoqërisë janë Z. Fatbardh Cangu dhe Z. Georg Schweighofer.

Selia e shoqërisë më 31 dhjetor 2012 është në Rr. "Eqerem Çabej", Nr 6/2, Tiranë, Shqipëri. shoqëria është regjistruar si një person i tatueshëm në Zyrën Tatimore të Rrethit të Tiranës.

Numri i personelit më 31 dhjetor 2012 është 2 (31 dhjetor 2011: 1).

### Kontrata koncesionare

Në përputhje me kontratën e koncesionit të formës BOT (Build, Operate, Transfer ose Ndërtim, Operim, Transferim) të datës 17 Prill 2008 (kontrata e koncesionit) ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, bazuar më vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 136 datë 14. 03. 2007 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për dhënien me koncesion të hidrocentralit Lengarica 1 dhe Lengarica 2", ndryshuar më 25 Prill 2009, dhe shoqërisë Hasi Energji sh. p. k, kjo e fundit krijoi shoqërinë Lengarica & Energy sh. p. k.

Shoqëria Lengarica & Energy sh. p. k. zotëron të gjitha të drejtat dhe detyrimet që vijnë si rezultat i marrëveshjes koncesionare. shoqëria Hasi Energji sh. p. k. detyrohet të zbatojë kontratën deri në momentin e kontraktimit të shoqërisë ndërtuese që do të vijojë me ndërtimin e objektit.

Lengarica & Energy sh. p. k në përputhje me të njëjtën kontratë ka si objektiv të vetëm të aktivitetit të saj dizenjimin, ndërtimin dhe vënien në punë, administrimin dhe transferimin e hidrocentralit tek autoriteti kontraktor në fund të periudhës së koncesionit.

Autoriteti kontraktor garanton blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh. a. për 15 vitet e para të prodhimit. Pas kësaj periudhe, shoqëria është e lirë të shesë energjinë elektrike të prodhuar në treg.

Në përputhje me ndryshimet e bëra në kontratën e koncesionit datë 25 Prill 2009, shoqëria do të ndërtojë dhe përdorë hidrocentralin Lengarica në Petran në qytetin e Përmetit me një fuqi të instaluar prej 8,906 kW dhe prodhim vjetor të energjisë prej 36,000,000 kW/h gjatë periudhës 35 vjeçare të marrëveshjes koncesionare.

Investimi total i rënë dakord për t'u bërë është 1,908,714 mije Lekë.

Tarifa koncesionare e cila do të paguhet nga shoqëria është 2.1% e energjisë së prodhuar. shoqëria detyrohet të riinvestojë 42% të vlerës së investimit total për makineri dhe pajisje në mënyrë që të transferojë aktivin tek autoriteti kontraktor në kushte të plota pune.

### 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave

#### 2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Sipas SKK 11 "Tatim Fitimi", paragrafi 4, shoqëria ka zgjedhur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra në pasqyrat financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2012.

#### 2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

#### 2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë, monedha a ambientit ekonomik kryesor në të cilin shoqëria kryen aktivitetin e saj.

---



## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

---

### 2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të ushtrojë gjykim në procesin vlerësimeve dhe supozimeve që ndikojnë zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga këto rishikime.

Në veçanti, informacioni në lidhje me fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pësigurisë dhe gjykimeve në zbatimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të konsiderueshëm ndaj shumave të njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke pasur parasysh thjeshtësinë e natyrës së veprimeve së shoqërisë.

### 3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

#### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi i zërave monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurset e ndryshme përkatëse të këmbimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.2 Instrumente financiarë

Instrumentet financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentet financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Pas njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjete monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtër me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit të tyre.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme për llogaritë kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha të drejtat sipas kushteve fillestare të tyre. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme janë të mbivlerësuara. Shuma e provigjoni llogaritë si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara monetare të skontuara me normën efektive të interesit.

# Lengarica & Energy sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

---

### *Llogaritë e arkëtueshme koncesionare*

Shuma për t'u arkëtuar nga KESH (e drejta e shoqërisë për të kërkuar pagesë nga ana e KESH në lidhje me shitjen e energjisë në 15 vitet e para të veprimtarisë së objektit të koncesionit) njihet në pasqyrat financiare si aktiv financiar (llogari të arkëtueshme nga koncesioni) dhe klasifikohen si të tilla.

Në përputhje me marrëveshjen e koncesionit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shoqëria ka të drejtën të faturojë për shitjen e energjisë elektrike ndaj KESH (shitja e të cilës është garantuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) për 15 vitet e para të veprimtarisë së hidrocentralit të Lengaricës.

Vlera e aktivitetit financiar është llogaritur në përpjesëtim të drejtë për periudhën e koncesionit, 15 vjet nga 35 vjet, për të gjitha kostot e ndërtimit deri në datën e raportimit.

### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme njihen me vlerë të drejtë dhe maten më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### *Huamarrjet*

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe maten më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### *Të tjera*

Instrumente të tjerë financiar jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

## **3.3 Aktive afatgjata materiale**

### *(i) Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur zbatohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

### *(ii) Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin

### *(iii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve jomateriale dhe përmirësimit të ambienteve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivet e tjera. Afatgjata mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale është si më poshtë:

---

# Lengarica & Energy sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Kategoritë	Metoda e amortizimit	Norma amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mobilie dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyrash dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mijete Transporti	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

### 3.4 Aktivet afatgjata jomateriale

Të ardhurat që do të merren nga marrëveshja e koncesionit për ndërtimin e objektit të marrëveshjes njihen me vlerën e drejtë, në përputhje me KIRFN 12.

Shoqëria ka zbatuar modelin e kombinuar të KIRFN 12 në mungesë të udhëzimeve specifike nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Në përputhje me marrëveshjen e koncesionit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shoqëria ka të drejtën të faturojë për shitjen e energjisë elektrike ndaj KESH (shitja e të cilës është garantuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) për 15 vitet e para të veprimtarisë së hidrocentralit të Lengaricës. Pas kësaj periudhe, shoqëria është e lirë të shesë energjinë elektrike të prodhuar në treg.

Shuma për t'u arkëtuar nga KESH (e drejta e shoqërisë për të kërkuar pagesë nga ana e KESH në lidhje me shitjen e energjisë në 15 vitet e para të veprimtarisë së objektit të koncesionit) njihet në pasqyrat financiare si aktiv financiar (llogarë të arkëtueshme nga koncesioni) dhe klasifikohen si të tilla.

Diferenca e kostove të ndërtimit njihet si aktiv afatgjatë jomaterial dhe do të amortizohet përgjatë jetës së mbetur të marrëveshjes së koncesionit pas mbarimit të periudhës së shitjeve të garantuara prej 15 vjetësh.

Shoqëria njeh aktivet jomateriale deri në masën që shoqëria ruan të drejtën për të faturuar klientët e saj përgjatë periudhës 20 vjeçare të koncesionit.

Vlera fillestare përfaqëson diferencën midis kostos së ndeshur për ndërtimin e objektit të koncesionit dhe aktivitetit të njohur financiar.

Modeli i përdorur nga shoqëria është modifikuar duke shpërndarë në përpjesëtim të drejtë shumat midis aktiveve financiare dhe atyre afatgjata jomateriale.

Duke qenë se shoqëria do të paguhet pjesërisht nga një aktiv financiar (shuma e garantuar) dhe pjesërisht nga aktive afatgjata jomateriale (diferenca apo e drejta për të përdorur objektin më pas), secili përbërës kontabilizohet veçmas.

Vlera e aktivitetit financiar është vlerësuar në përpjesëtim të drejtë me kostot e ndërtimit deri në momentin e raportimit.

Aktivi afatgjatë jomaterial është njohur për diferencë midis totalit të kostove dhe aktivitetit financiar.

### 3.5 Zhvlerësimi

#### (i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

# Lengarica & Energy sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

---

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### (ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.6 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

### 3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

### 3.8 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.9 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

# Lengarica & Energy sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 4. Aktive afatgjata materiale

	Mjete transporti	Mobilie dhe orendi	Pajisje zyrash dhe informatike	Totali
<b>Kosto</b>				
Më 1 janar 2011	-	438,197	-	438,197
Shtesa	-	-	63,670	63,670
Më 31 dhjetor 2011	-	438,197	63,670	501,866
Shtesa	1,120,160	-	433,505	1,553,665
Më 31 dhjetor 2012	1,120,160	438,197	497,175	2,055,531
<b>Amortizim i akumuluar</b>				
Më 1 janar 2011	-	-	-	-
Shtesa	-	(87,639)	(6,635)	(94,274)
Më 31 dhjetor 2011	-	(87,639)	(6,635)	(94,274)
Shtesa	(168,024)	(70,111)	(41,353)	(279,488)
Më 31 dhjetor 2012	(168,024)	(157,750)	(47,988)	(373,762)
<b>Vlera kontabël neto</b>				
Më 1 janar 2011	-	438,197	-	438,197
Më 31 dhjetor 2011	-	350,558	57,035	407,592
Më 31 dhjetor 2012	952,136	280,446	449,187	1,681,770

### 5. Aktive afatgjata jomateriale

	Aktivet afatgjata jomateriale
<b>Kosto</b>	
Më 1 janar 2011	11,684,584
Shtesa	65,472,602
Më 31 dhjetor 2011	77,157,186
Shtesa	45,354,079
Më 31 dhjetor 2012	122,511,265
<b>Amortizim i akumuluar</b>	
Më 1 janar 2011	-
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2011	-
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2012	-
<b>Vlera kontabël neto</b>	
Më 1 janar 2011	11,684,584
Më 31 dhjetor 2011	77,157,186
Më 31 dhjetor 2012	122,511,265

# Lengarica & Energy sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 6. Llogari të arkëtueshme nga koncesioni

Aktivi financiar është njohur në masën 43% ndaj kostove të konstruksionit të realizuara deri në momentin e raportimit me vlerë 91,883 mijë Lekë. Aktivi financiar matet me kosto të amortizuar.

### 7. Aktive të tjera afatshkurtra

	31. 12. 2012	31. 12. 2011
		<b>paaudituar</b>
TVSH e arkëtueshme	28,119,013	16,319,640
Parapagime	2,049,732	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	185,650	-
	<b>30,354,395</b>	<b>16,316,640</b>

### 8. Mjete monetare

	31. 12. 2012	31. 12. 2011
		<b>paaudituar</b>
Banka në Lekë	1,737,735	300,000
Banka në Euro	47,366,042	26,037,182
Arka	69,117	-
<b>Totali</b>	<b>49,172,894</b>	<b>26,337,182</b>

### 9. Kapitali

Kapitali i nënshkruar përbëhet nga 344,100 aksione me vlerë nominale 1,000 ALL për aksion

Lëvizjet në pasqyrën e kapitalit janë si më poshtë:

	Nr. aksioneve	Vlerë nominale
<b>Më 1 janar 2011</b>	100	100,000
Kapitali	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2011</b>	<b>100</b>	<b>100,000</b>
Rritje kapitali	344,000	344,000,000
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>344,100</b>	<b>344,100,000</b>

### 10. Llogari të pagueshme

	31. 12. 2012	31. 12. 2011
		<b>paaudituar</b>
Furnitorë	5,574,403	15,536,585
Detyrime ndaj palëve të lidhura	8,111,279	24,588,916
	<b>13,685,682</b>	<b>40,125,501</b>

Furnitorët me palët e lidhura konsistojnë kryesisht në shërbimet e konsulencave ligjore dhe teknike.

# Lengarica & Energy sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 11. Huamarrjet

	31. 12. 2012	31. 12. 2011
		<b>paaudituar</b>
Huamarrje nga palët e lidhura	-	148,516,170
Interes i përllogaritur	-	2,876,415
	-	<b>151,392,585</b>

Huat e marra nga Enso Hydro GmbH konsistojnë në shumat të transferuara për t'u përdorur për investimet e kryera në lidhje me objektin e koncesionit.

### 12. Detyrime të tjera

	31. 12. 2012	31. 12. 2011
		<b>paaudituar</b>
Shpenzime të përllogaritura	27,848,205	15,396,454
Detyrime ndaj punonjësve	2,076,995	1,464,421
Detyrime tatimore për tatimin ne burim	1,580,677	-
Detyrime ndaj aksionarëve	-	399,700
Detyrime të tjera	163,599	390,286
Detyrime tatimore për TAP-in	7,602	8,410
	<b>31,677,078</b>	<b>17,659,271</b>

### 13. Shpenzime për personelin

	31. 12. 2012	31. 12. 2011
		<b>paaudituar</b>
Pagat e personelit	867,233	1,799,360
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	-	209,532
	<b>867,233</b>	<b>2,008,892</b>

### 14. Shpenzime të veprimtarisë

	31. 12. 2012	31. 12. 2011
		<b>paaudituar</b>
Konsulencë ligjore	27,480,519	5,909,254
Shpenzime të tjera për konsulenca	6,051,332	1,123,623
Konsulencë financiare e shpenzime auditimi	3,598,881	2,958,850
Shpenzime të tjera	2,010,955	248,504
Qira zyre	1,987,973	2,421,800
Shpenzime për mjetet e transportit	701,197	85,036
Shpenzime figuracioni	700,786	2,632,435
Shpenzime përkthimi	670,084	302,626
Shpenzime transporti	544,763	821,829
Shpenzime qiraje përveç qirasë së zyrës	524,930	1,609,437
Shpenzime udhëtimi	520,175	482,043
Shpenzime për materiale zyre	494,895	193,725
Shpenzime përfaqësimi	380,267	462,922
Shpenzime administrative	213,195	328,587
Shpenzime telefoni	101,118	

# Lengarica & Energy sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	31. 12. 2012	31. 12. 2011
		<b>paaudituar</b>
Taksa	18,121	18,120
Shpenzime për internetin	-	393,446
Mirëmbajtje e riparime	-	110,983
<b>Totali</b>	<b>45,999,191</b>	<b>20,103,220</b>

### 15. Të ardhura dhe shpenzime financiare

	31. 12. 2012	31. 12. 2011
		<b>paaudituar</b>
Shpenzime interesi	(14,917,180)	(5,457,313)
Të ardhura nga interesi	-	10,430
Fitime të realizuara nga kursi i këmbimit	787,568	3,755,901
Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit	(2,239,270)	(2,218,772)
<b>Totali</b>	<b>(16,368,882)</b>	<b>(3,909,754)</b>

### 16. Tatim-fitimi

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 10% për vitin 2012 (2011: 10%).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime provizore deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin përfundimtar. Legjislacioni fiskal shqiptar është subjekt interpretimesh nga autoritetet fiskale.

	31. 12. 2012	31. 12. 2011
		<b>paaudituar</b>
Humbja e vitit	(62,663,121)	(26,116,140)
Shpenzimet e pazbritshme	35,055,731	8,155,499
<b>Humbja e mbartur e vitit</b>	<b>(27,607,390)</b>	<b>(17,960,641)</b>

### 17. Palë të lidhura

Gjendjet me palët e lidhura në datën e bilancit janë si më poshtë:

	Marrëdhënia	31. 12. 2012	31. 12. 2011
			<b>paaudituar</b>
<b>Aktive</b>			
<b><u>Aktivet afatgjata jomateriale dhe</u></b>			
<b><u>llogaritë e arkëtueshme nga koncesioni</u></b>			
Enso Hydro GmbH	Shoqëria mëmë	37,433,039	25,076,756
<b>Detyrime</b>			
<b><u>Llogari të pagueshme</u></b>			
Enso Hydro GmbH	Shoqëria mëmë	8,111,279	24,588,916
Aksionarë të tjerë		-	399,700
<b><u>Huat</u></b>			
Enso Hydro GmbH	Shoqëri mëmë	-	151,392,585



# Lengarica & Energy sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

---

### Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

#### Shpenzime interesi

	Shoqëri mëmë		
Enso Hydro GmbH		14,917,180	5,457,313

#### 18. Angazhime dhe detyrime e të drejta të kushtëzuara

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së biznesit, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, përfundimet e këtyre çështjeve nuk do të kenë ndikime të rëndësishme negative në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

#### *Pasiguri në lidhje me tatimet*

Legjislacioni tatimor shqiptar në fuqi në fund të periudhës raportuese është subjekt interpretimesh të ndryshme kur zbatohet ndaj veprimeve dhe aktiviteteve të shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor i përcaktuar nga drejtimi dhe dokumentacioni formal i cili mbështet këtë pozicion mund të kundërshtohet nga autoritetet tatimore. Periudhat fiskale konsiderohen të hapura për rishikim të çështjeve tatimore nga autoritetet fiskale për tre vite kalendarike duke filluar nga viti para se të merret një vendim në lidhje me rishikimin. Në raste të caktuara, rishikimet mund të mbulojnë një periudhë më të gjatë.

Detyrimet e regjistruara në lidhje me pozicionin fiskal të shoqërisë janë përcaktuar nga drejtimi duke u bazuar në rezultatet më të mundshme në rast se përlogaritjet do të kryheshin nga autoritetet fiskale. Vlerësimi bazohet në interpretimet e legjislacionit tatimor që është në fuqi në fund të periudhës së raportimit dhe ndonjë vendim gjyqësor apo interpretim i njohur i autoriteteve. Detyrimet për penalitete, interesa dhe tatime të tjera përveç tatimit mbi të ardhurat njihen në bazë të vlerësimeve më të mira të drejtimit në lidhje me shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës së raportimit.

#### 19. Ngjarje të mëpasshme

Më 12 shkurt 2013, shoqëria ndryshoi adresën e selisë së saj në Rr. "Jul Variboba". Nr. 10, Tiranë, Shqipëri.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkojë rregullime apo shënime të tjera shpjeguese në këto pasqyra financiare.